

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS

ZYA E SUPERINTENDENTIT

440 NORTH BROAD STREET, SUITE 301

PHILADELPHIA, PENNSYLVANIA 19130

WILLIAM R. HITE, JR., Ed.D.
SUPERINTENDENT

TELEFON (215) 400-4100
FAX (215) 400-4103

15 Gusht 2014

Letër e Hapur nga Superintendenti William R. Hite:

Sot, vetëm tre javë nga fillimi i vitit të ri shkollor, ne përsëri do të na duhet të bëjmë zgjedhje shumë të vështira. Ashtu si e kemi deklaruar më shumë se një muaj më përpara, buxheti ynë i këtij viti shkollor është i pambuluar në masën e \$81 milion, të cilat duhet të përballohen nëpërmjet të ardhurave të tjera shtesë, ose uljes së kostos së shpenzimeve.

Për hir të minimizimit të shqetësimeve në familje dhe për hir të edukimit të fëmijëve, ne kemi marrë vendime për ulje të tjera shtesë të shpenzimeve - masa të vështira- dhe shpresojme të përkohëshme, për hapjen në kohë të shkollave.

Për arritjen e këtij përfundimi, ne u përqëndruam kryesisht në pasojat që do të rridhnin nga moshapja në kohë e shkollave për familjet dhe nxënësit- dhe më e rëndësishmja-, nga humbja e kohës së qëndrimit në klasa për nxënësit. Si drejtori arsimore, përparësia jonë është në maksimalizimin e mundësive për të mësuar të nxënësve tanë. Vonesa në hapjen e shkollës - kohë në të cilën ne do të vazhdonim të kryenim pagesat për punonjësit tanë, për shkollat charter dhe pagesat për kontratat e tjera, ndërsa të gjithë nxënësit nuk janë në mësim- do të dëmtonte nxënësit për mangesitë e të rriturve.

Ne gjithashtu morëm në konsideratë faktin se vonesa në hapjen e shkollës, deri sa ne të kishim me tepër siguri për të ardhurat shtesë , potencialisht mund të rritë me shumë deficitin tonë, në rast se psh. nxënës të tjerë do të kalojnë për në shkollat charter.

Së fundmi, ne vlerësuam angazhimin publik të Guvernatorit dhe Drejtuesit të Grupit Parlamentar të Shumicës, që ata do të bëjnë të gjitha përpjekjet që ligji për taksimin e ri të cigareve do të kalojë në mbledhjen e muajit të ardhshëm të Asamblesë së Përgjithëshme Parlamentare. Ne i çmojmë përpjekjet e vazhdueshme dhe drejtimin e delegacionit të Filadelfias, të Kryetarit të Bashkisë dhe të Këshillit të Qytetit, në këtë qëllim.

Duke i peshuar të gjithë faktorët e mësipërm, ne vendosëm që hapja në kohë e shkollave, me shkurtime e mëtejshme, ishte edhe zgjidhja më e mirë për nxënësit dhe familjet. Në përshtatje me situatën, ne do të zbatojmë shkurtime të shërbimeve si më poshtë:

- Nxënësit e shkollave të mesme, të cilët banojnë në distancë dy (2) milje nga shkolla, nuk do të marrin shërbim falas të transportit (një rritje nga 1.5 milje). Si rrjedhojë, afërsisht 7,500 nxënës të Drejtorisë, të shkollave charter, dhe shkollave jo publike, nuk do të kenë më tutje shërbim falas transporti.
- Afërsisht 300 nxënës do të ndikohen nga shkurtimi i programeve të shërbimeve për rrugët e ndryshme të diplomimit, çka do të rezultojë në më pak mundësi cilësore për nxënësit.
- Eliminimi për mësuesit i përgatitjeve dhe kualifikimit profesional, përpara hapjes së shkollave, në disa prej shkollave tona më dinamike, Akademive Premtuese (Promise Academies).

- Shkollat do të pastrohen më rrallë dhe do të përdorin më pak mjete pastrimi; riparimet në shkolla do të shtyhen për një kohë më të vonë.
- Drejtoria do të lerë të paplotësuara vendet e lira të punonjësve të policisë, duke e reduktuar numrin e përgjithshëm të policëve, që ndihmojnë për klimën dhe sigurinë e shkollave.
- Reduktimi i mëtejshëm i personelit të departamenteve do të rezultojë në mbështetjen direkte të shkollave dhe familjeve. Detajet në lidhje me këto reduktime do të sqarohen në vazhdimësi gjatë punës me personelin tonë.

Ne gjithashtu supozojmë – dhe këto janë supozime me rrisht të lartë- se ne do të mund të negociojmë me shitësit tanë kryesorë, se do të realizojmë të tjera të ardhura shtesë prej shitjeve të godinave tona dhe se do të mbajmë shkollat charter vetëm nëpërmjet pagesave nga shteti, për nivele pranimi të autorizuara.

Ndërsa ne do të shkurtojmë kaq shumë në shërbimet tona kryesore, ne përsëri do të kërkojmë prej financuesve tanë dhe sindikatave të ndryshme, që të na ndihmojnë që të mos përkeqësohet më tej gjendja në shkollat tona dhe përvoja mësimore për nxënësit tanë.

Ne do të kërkojmë prej përfaqësuesve legjislativë të shtetit, që të përshpejtojnë venien në fuqi të taksës së cigareve vetëm për Filadelfian, nga e cila pritet të gjenerohen rreth \$49 milion këtë vit, nëse kjo taksë hyn në fuqi në datën 1 Tetor. Çdo vonesë në aplikimin e kësaj takse, rezulton në humbjen e milionave dollarëve në të ardhurat.

Ne do të kërkojmë prej Sindikatës së Mësuesve të Filadelfias (PFT) që të bëjnë lëshime në linjën e lëshimeve të bëra prej drejtorëve, punonjësve ndihmës dhe personelit që nuk është në sindikatë. Ne nuk kërkojmë një reduktim të gjerë të pagës nga ana e PFT, por më tepër një ndryshim të përfitimeve, që mund të na lejojë rikthimin në shkolla të mjaft shërbimeve kryesore.

Në rast se shteti dhe PFT nuk do të gjejnë rrugë për mbulimin e asaj çka ngel në defiçitin e \$81 milionëve, pas shkurtimeve të shpallura sot, ne do të detyrohemi që në mes të muajit Tetor, të bëjmë shkurtime në buxhetet e shkollave, të cilat nënkuptojnë rritjen e madhësive të klasave dhe një rritje në klasat e përziera , ose të ndara (split).

Që të jem i qartë, duke plotësuar defiçitin prej \$81 milion, kjo do të mundësonte Drejtorinë të kthejë në veprim përsëri ato burime të pamjaftueshme, që kishin shkollat vitin e kaluar. Bërja e investimeve transformuese në shkollat tona, kërkon të ardhura të tjera të reja, përfshirë një formulë më të drejtë të fondeve nga shteti për koston e ristrukturimeve, si edhe një reformë tërësore të strukturës së përfitimeve të punonjësve tanë.

Të rriturit kanë forcën të bëjnë edhe të mirën edhe të keqen për shkollat dhe nxënësit tanë. Ofrimi për të gjithë fëmijët i një edukimi me cilësi të lartë, nuk është vetëm një e drejtë bazë, por edhe një detyrim moral. Unë kam shpresë, se të gjithë banorët e Filadelfias do t'i bashkohen përpjekjeve të Drejtorisë, në realizimin e më të mirës për nxënësit tanë.

Sincerely,



William R. Hite, Jr., Ed.D